



Buletini

- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)
- * Aktivitetet nga Programi për Satfin administrative të gjykatave dhe prokurorive
- * Aktivitetet tjera

Prill 2018

Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Para-kontrata dhe konvalidimi i kontratave

Më 03 prill 2018, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, organizoi trajnimin me temë: “Para-kontrata dhe konvalidimi i kontratave”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me para-kontratat dhe konvalidimin e kontratave në Republikën e Kosovës.

Gjatë trajnimit u trajtuan përbërja e para-kontratës, kushtet për lidhjen dhe efektet e saj duke u shoqëruar me pyetjet e pjesëmarrësve dhe shpjegimet e trajnuesve. Pastaj u vazhdua me trajtimin e konvalidimit të kontratave dhe rekomandimet për të ardhmen.

Në fokus të trajnimit ishin çështjet që ndërlidhen me kontratat, e në veçanti me detyrimet dhe përgjegjësinë para-kontraktuese, si dhe problemet aktuale në fushën e zbatimit të këtyre kërkesave ligjore në praktikë, dhe një shtjellim i përgjithshëm i dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, për këtë institut juridik.

Në vazhdim u veçua mendimi se parimi i mirëbesimit dhe bërjes së marrëveshjeve të drejta në marrëdhëniet parakontraktuese është

parim i vjetër në traditën juridike evropiane dhe zbatohet në të gjitha sistemet juridike nacionale të shteteve anëtare të BE-së dhe është i paraparë në disa direktiva të BE-së, duke e bërë këtë parim të detyrueshëm në shtetet anëtare si standard i BE-së në fazën parakontraktuese dhe si pjesë të përmbushjes së kontratës.

Në trajnim u veçua edhe mendimi se Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, në nenin 20 të tij, përmban një bazë juridike për mundësinë e krijimit të detyrimeve dhe përgjegjësisë parakontraktuese, pra edhe për rastet nëse palët akoma nuk kanë hyrë në një marrëdhënie kontraktuese.

Gjatë trajnimit pjesëmarrësit morën pjesë në një debat të frytshëm dhe interaktiv lidhur me pyetjet dhe paqartësitë e ngritura përmes analizës së dispozitave ligjore dhe mënyrave si duhet zbatuar drejta ato në praktikë, gjithashtu u përdoren edhe metoda e shpjegimit të pjesshëm teorik, raste nga praktika gjyqësore vendore dhe shteteve të rajonit.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e gjykatave themelore - departamentet e përgjithshme- divizionet civile, gjyqtarët nga departamenti për çështje ekonomike, bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtar ligjor.



Mbrojtja e dëshmitarëve

Më 05 prill 2018, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit të Trajnimit të Vazhdueshëm ka realizuar trajnimin me temë “Mbrojtja e dëshmitarëve”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve që përmes diskutimeve, prezantimit të praktikave më të mira dhe elaborimit të dilemave, të kontribuojnë në mbrojtjen më efektive të dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor.

Në fokus të trajnimit ishte mbrojtja e dëshmitarëve si kategori të posaçme të cilat janë normuar në Kodin e Procedurës Penale Kosovës si dhe me Ligjin për Mbrojtjen e Dëshmitarëve, të cilat paraqesin kategori të rëndësishme në procesin penal.

Vëmendje parësore iu kushtua rasteve nga praktika, ku në të shumën e rasteve, të dëmtuarit dhe dëshmitarët nuk dëshmojnë për shkak të ndjenjës së rrezikut për shëndetin, jetën e tyre dhe anëtarëve të familjes. Andaj, në procedurën penale, mbrojtjes së dëshmitarëve duhet t'i kushtohet kujdesi i duhur, që të njëjtit mos të kenë ndonjë ndërhyrje ose shqetësim eventual nga jashtë dhe brenda.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë të nivelit themelor, nga regjione të ndryshme të Kosovës.



Veprat penale kundër integritetit seksual

Më 10 prill 2018, Akademia e Drejtësisë, me mbështetje të GIZ-it, organizoi trajnimin me temë “Veprat penale kundër integritetit seksual”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve, lidhur me veprat penale kundër integritetit seksual sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Fillimisht në trajnim u trajtuan veprat penale kundër integritetit seksual të përcaktuara në Kapitullin XX të Kodit Penal të Kosovës, me theks të veçantë u analizuan format e paraqitjes së dhunimit dhe veprave të ngjashme lidhur me

integritetin seksual.

Po ashtu, gjatë trajnimit vëmendje iu kushtua elementeve dhe karakteristikave të veprave penale kundër integritetit seksual të fëmijëve, me ç’rast u paraqiten raste nga praktika, përmes të cilave u shtjelluan sfidat që po përballem gjyqtarët dhe prokurorët.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor nga regjione të ndryshme të Kosovës.



Forcimi i kapaciteteve për hetime penale kundër korrupsionit me partnerët e drejtësisë penale në rajonin e Mitrovicës

Më 13 prill 2018, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me EULEX, organizoi trajnimin me temën “Forcimi i kapaciteteve për hetim penal kundër korrupsionit me partnerët e drejtësisë penale në Rajonin e Mitrovicës”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me teknikat e hetimit efektiv penal në rastet e korrupsionit dhe rasteve të lidhura me korrupsionin.

Gjatë këtij sesioni trajnues u trajtuan ligjet vendore, KPP, Ligji për Bashkëpunimin Ndërkombëtar në Çështjet Penale, Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe ndihma e përbashkët juridike. Me theks të veçantë u theksua procesi i bashkëpunimit ndërkombëtar përmes së cilit Shtetet kërkojnë dhe japin ndihmë në mbledhjen e provave për ti përdorur ato në hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve penale.

Në trajnim vëmendje iu kushtua parimeve të ndihmës së përbashkët juridike si reciprocitetit, marrëveshjeve bilaterale, marrëveshjeve

multilaterale, forcimit të efektivitetit të autoritetit qendror, shkëmbimet e personelit në mes autoriteteve qendrore të juridiksioneve të ndryshme, si dhe efikasitetit të kontakteve të drejtpërdrejta personale në mes shteteve që kërkojnë dhe atyre që pranojnë ndihmë juridike.

Në kuadër të këtij sesioni trajnues u trajtua edhe bashkëpunimi lidhur me konfiskimin, përmbarimin e konfiskimit civil dhe ndarjen e pasurive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: prokurorë nga niveli themelor, përfaqësues nga Dogana e Kosovës, përfaqësues nga Agjensioni kundër Korrupsionit, përfaqësues nga Policia e Kosovës, përfaqësues nga Agjensioni për Pasurinë e Sekuestruar, përfaqësues nga Njësia për Inteligjencë Financiare, përfaqësues nga Inspektorati Policor, përfaqësues nga ATK dhe përfaqësues nga Komuna - zyra kadastrale nga Regjioni i Mitrovicës.



Bashkëpunimi juridik ndërkombëtarë

Më 17 prill 2018, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme ka realizuar trajnimin me temë “Bashkëpunimi juridik ndërkombëtarë”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me bashkëpunimin juridik ndërkombëtarë në procedurën penale, që zhvillohet kur kemi të bëjmë me zbatimin sa më të suksesshëm të dispozitave ligjore në sigurimin e provave të ndryshme, në zgjidhjen e kërkesave për ndihmë juridike ndërkombëtare dhe në çështjet e ekstradimit.

Gjatë trajnimit u trajtua bashkëpunimi juridik ndërkombëtarë që paraqitet si nevojë, meqë krimi i ka tejkaluar kufijtë e brendshëm dhe ka marrë dimension ndërkombëtarë. Në këtë botë gjithnjë e më të ndërvarur, asnjë vend nuk mund

të luftoj krimin në mënyrë efektive pa bashkëpunim mes shteteve për të parandaluar dhe për të zbuluar krimin.

Për shkak të rrethanave në të cilat sot gjendet shoqëria njerëzore, sidomos për shkak të zgjerimit të mundësive që kanë kryesit e veprave penale për tejkalim të kufijve, gjyqtarët dhe prokurorët duhet të njihen me praktikat efikase të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet penale e cila u trajtua në kuadër të këtij trajnimi.

Përfitues të këtij trajnimi ishin prokurorë nga Prokuroria Speciale, si dhe gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor, nga regjione të ndryshme të Kosovës.



“Bazat e thirrjes në trashëgimi dhe rendet ligjore të trashëgimisë”

Më 19 prill 2018, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme organizoj trajnimin me temë: “Bazat e thirrjes në trashëgimi dhe rendet ligjore të trashëgimisë”.

Gjatë trajnimit u trajtuan trashëgimia me ligj, trashëgimia me testament dhe rendet ligjore të trashëgimisë, pjesa e domosdoshme e trashëgimisë, përjashtimi nga trashëgimia dhe procedura për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore.

Në trajnim u potencua se Ligji për Trashëgiminë parasheh bazat për thirrje në trashëgimi, rendet ligjore të trashëgimisë, si dhe procedurën gjyqësore e cila ka të bëjë me shqyrtimin e pasurisë trashëgimore të trashëgimlënësit. Gjithashtu u theksua se ky ligj ka paraparë edhe trashëgimtarët e pjesës së domosdoshme të trashëgimisë, e që në praktikën gjyqësore ka vështirësi dhe dilema rreth përcaktimit të vëllimit të pjesës së domosdoshme dhe personave që e gëzojnë këtë të drejtë por edhe në çështjet që kanë të bëjnë me bazat e thirrjes në trashëgim dhe rendet ligjore të trashëgimisë.

Në fokus të trajnimit ishte edhe evitimi i dilemave si dhe unifikimi i praktikës gjyqësore për çështjet e lartcekura, posaçërisht në pjesën

që ka të bëjë me kompetencën – se kush ka të drejtë të vendos në lidhje me zhvillimin e procedurës për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore, gjykatat apo noterët – kjo për shkak të mosharmonizimit të dispozitave të Ligjit për Trashëgiminë dhe Ligjit për Procedurën Jokontestimore me Ligjin për Noterinë.

Në trajnim u potencua se në bazë të ligjit baza e thirrjes në trashëgimi është e lidhur me ekzistimin e fakteve të caktuara që kanë lidhmëri me afërsinë familjare të trashëgimlënësit.

Trashëgimia me ligj zakonisht vije në shprehje kur trashëgimlënësi nuk ka lënë testament ose kur ka lënë testament, por ka disponuar me një pjesë të pasurisë trashëgimore dhe në rastet kur testamenti i hartuar është pjesërisht ose tërësisht i pa vlefshëm.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e gjykatave themelore – departamenteve të përgjithshme - divizionet civil si edhe bashkëpunëtorët profesional në gjykata.



Shkathtësitë teknike për intervistimin e dëshmitarëve/viktimave të krimeve të luftës me fokus në rastet e dhunës seksuale dhe gjinore në konfliktet e armatosura

Më 19-20 prill 2018, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me EULEX-in, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme ka realizuar trajnimin me temë “Shkathtësitë teknike për intervistimin e dëshmitarëve/viktimave të krimeve të luftës me fokus në rastet e dhunës seksuale dhe gjinore në konfliktet e armatosura”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive profesionale të pjesëmarrësve përmes elaborimit të rasteve nga praktika lidhur me shkathtësitë teknike për intervistimin e dëshmitarëve/viktimave të krimeve të luftës me fokus në rastet e dhunës seksuale dhe gjinore në konfliktet e armatosura.

Ky trajnim ka trajtuar çështjet rreth krimeve të luftës sipas të drejtës ndërkombëtare dhe ligjit të Kosovës. Gjatë këtij trajnimi u diskutuan

çështjet që kanë të bëjnë me elementet e krimeve që duhet të dëshmohen me theks të veçantë planifikimit të një interviste të një viktime apo dëshmitari që ka të bëjë me krimet e luftës sipas së drejtës ndërkombëtare penale, si dhe rreth identifikimit të sfidave gjatë intervistimit të dëshmitarëve dhe viktimave.

Gjatë trajnimit pjesëmarrësit kanë diskutuar rastet nga praktika si dhe përmes punës në grupe është demonstruar përgatitja po ashtu edhe intervistimi i dëshmitarëve.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë, prokurorë të nivelit themelor nga të gjitha regjionet e Kosovës.

Fillimi dhe zhvillimi i procedurës së konfliktit administrativ

Më 24 prill 2018, Akademia e Drejtësisë, me mbështetje të GIZ-it, në kuadër të Programit të Trajnimit të Vazhdueshëm, realizoj trajnimin me temë: “Fillimi dhe zhvillimi i procedurës së konfliktit administrativ”.

Në këtë trajnim u trajtuan dispozitat ligjore për procedurën e konfliktit administrativ dhe procedura ligjore në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore dhe mjetet juridike kundër vendimeve të saj, si dhe përmbarimi i vendimeve të Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore të Prishtinës.

Në trajnim dominuan çështjet që ndërlidhen me mbrojtjen gjyqësore dhe adresimin e ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe të Gjykatës së Apelit. Gjithanshëm u shtjelluan dilemat e ndryshme që po paraqiten në gjykata si ato profesionale, procedurale dhe materiale gjatë vendosjes së këtyre lëndëve. Në vijim u potencua se qëllimi i dispozitave të LKA-së është sigurimi i mbrojtjes gjyqësore të të drejtave dhe interesave juridike të personave fizik, juridik dhe palëve të tjera të cilat të drejta dhe interesa janë cenuar me

vendime individuale ose me veprime të organeve të administratës publike.

Gjatë trajnimit fokusi ishte edhe në bazën ligjore të funksionimit të organeve administrative dhe procedurës së përgjithshme administrative në Republikën e Kosovës, kjo për synim të zbërthimit të procedurës administrative pranë organeve publike që shërben si bazë për fillimin e procedurës së konfliktit administrativ në gjykata, në këtë kontekst u paraqit një vështrim i përgjithshëm i Ligjit për Procedurën Administrative, gjegjësisht ndryshimeve që ka përcaktuar ky ligj dhe si do të reflektohen këto ndryshime në punën e gjykatave gjatë zhvillimit të procedurës në fjalë.

Në këtë trajnim u ofruan zgjidhje praktike të bazuara në ligj të cilat do të lehtësojnë punën e gjyqtarëve, dhe në instancë të fundit do të ndikojnë në reduktimin e përgjithshëm të numrit të lëndëve në gjykata.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës së Apelit, dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë, si dhe gjyqtar nga gjykata themelore, të departamenti i përgjithshëm.



Etika Gjyqësore

Më 25 prill 2018, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit të Trajnimit të Vazhdueshëm, në bashkëpunim me Programin e USAID-it për fuqizimin e sektorit të drejtësisë në Kosovë - JSSP, ka realizuar trajnimin për gjyqtarët e Gjykatës Supreme dhe Gjykatës së Apelit me temë “Etika Gjyqësore”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve mbi Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarë përmes diskutimeve dhe prezantimit të rasteve praktike.

Në fokus të trajnimit ishte puna me raste hipotetike, duke identifikuar sjelljet e pahijshme dhe njëkohësisht duke zbërthyer dispozitat e

Kodit të Etikës për Gjyqtar veçanërisht të komunikimit midis një pale dhe gjyqtarit, përdorimi i mediave sociale, marrja e dhuratave, të cilat mund të krijojnë perceptimin e publikut se ekziston korrupsioni në sistemin gjyqësor.

Gjatë trajnimit si nga trajnuesit ashtu edhe nga pjesëmarrësit u theksua se gjyqtarët duhet të jenë të kujdesshëm dhe të matur, në mënyrë që të veprojnë me integritet si në jetën e tyre private, ashtu edhe në jetën profesionale.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 43 gjyqtarë, nga Gjykata Supreme e Kosovës dhe Gjykata e Apelit.



Çështjet e provave lidhur me ndjekjen penale të veprave që ndërlidhen me terrorizmin: Analiza e rasteve specifike dhe ndarja e praktikave të mira mbi forenzikën digjitale, përdorimin e internetit dhe shndërrimin e informatave të zbuluara në prova

Më 26 dhe 27 prill 2018, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me EULEX-in, në kuadër të Programit të Trajnimit të Vazhdueshëm, realizoi trajnimin me temë “Çështjet e provave lidhur me ndjekjen penale të veprave që ndërlidhen me terrorizmin: Analiza e rasteve specifike dhe ndarja e praktikave të mira mbi forenzikën digjitale, përdorimin e internetit dhe shndërrimin e informatave të zbuluara në prova”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me grumbullimin e provave në procedurën penale, kur kemi të bëjmë me veprat penale të terrorizmit si dhe format e bashkëpunimit ndërkombëtarë për zbulimin, hetimin dhe gjykimin e këtyre veprave penale që paraqesin kërcënim jo vetëm për shtetin por edhe më gjerë.

Gjatë trajnimit dy ditor u trajtua korniza ligjore ndërkombëtare që ka të bëjë me terrorizmin,

forenzika digjitale, dhe përdorimi i internetit në hetimin e rasteve të terrorizmit, duke përfshirë bashkëpunimin juridik ndërkombëtarë që paraqitet si nevojë, meqë krimi i ka tejkaluar kufijtë e brendshëm dhe ka marrë dimension ndërkombëtarë.

Për shkak të rrethanave në të cilat sot gjendet shoqëria njerëzore, sidomos për shkak të aktiviteteve terroriste, zgjerimit të mundësive që kanë kryesit e veprave penale për tejkalim të kufijve, gjyqtarët dhe prokurorët duhet të njihen me praktikat efikase të shndërrimit të informatave të inteligjencës në prova rreth përgjimeve të ligjshme për qëllime të sigurisë, si dhe të shkëmbimit të informacionit ndërmjet autoriteteve gjyqësore dhe kompanive private (ofruesve të shërbimeve të internetit) për sigurimin e ligjshëm të provave.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor, nga regjione të ndryshme të Kosovë

Etika Gjqësore

Më 26 prill 2018, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit të Trajnimit të Vazhdueshëm, në bashkëpunim me Programin e USAID-it për fuqizimin e sektorit të drejtësisë në Kosovë - JSSP, ka realizuar trajnimin për



gjqtarët e Gjykatës Themelore në Prishtinë me temë “Etika Gjqësore”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte që përmes diskutimeve dhe prezantimit të rasteve praktike

të avancojë njohuritë e pjesëmarrësve mbi Kodin e Etikës Profesionale për Gjqtarë.

Në fokus të trajnimit ishte puna me raste hipotetike duke identifikuar sjelljet e pahijshme dhe njëkohësisht duke zbërthyer dispozitat e Kodit të Etikës për Gjqtar veçanërisht tek komunikimet midis njëres palë dhe gjyqtarit, përdorimi i mediave sociale, marrja e dhuratave, të cilat mund të krijojnë perceptimin e publikut se ekziston korrupsioni në sistemin gjyqësor.

Gjatë trajnimit u theksua se, gjyqtarët duhet të jenë të kujdesshëm dhe të matur në mënyrë që të veprojnë me integritet si në jetën e tyre private ashtu edhe në jetën profesionale.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 38 gjyqtarë, nga Gjykata Themelore në Prishtinë, si dhe nga Dega në Podujevë, Gillogoc dhe Lipjan.



Etika Gjyqësore

Më 27 prill 2018, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit të Trajnimit të Vazhdueshëm, në bashkëpunim me Programin e USAID-it për fuqizimin e sektorit të drejtësisë në Kosovë - JSSP, ka realizuar trajnimin për gjyqtarët e Gjykatës Themelore në Mitrovicë me temë “Etika Gjyqësore”.

Qëllimi i trajnimit ishte mbështetja e vazhdueshme e gjyqtarëve në fushën e etikës profesionale, përmes diskutimeve dhe prezantimit të rasteve praktike për Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtar.

Trajnimit ishte fokusuar në punë me raste hipotetike, përmes të cilave janë identifikuar sjelljet e pahijshme dhe njëkohësisht duke

zërthyer dispozitat e Kodit të Etikës për Gjyqtar veçanërisht të komunikimet me palët në procedurë, përdorimi i mediave sociale, marrja e dhuratave, të cilat mund të krijojnë perceptimin e publikut se ekziston korrupsioni në sistemin gjyqësor.

Gjatë trajnimit u theksua se gjyqtarët duhet të jenë të kujdesshëm dhe të matur në mënyrë që të veprojnë me integritet si në jetën e tyre private ashtu edhe në jetën profesionale.

Përfitues të këtij trajnimit ishin 29 gjyqtarë, nga Gjykata Themelore në Mitrovicë, si dhe nga Dega në Vushtrri.



“Etika gjyqësore”

Më 30 prill 2018, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit të Trajnimit të Vazhdueshëm, në bashkëpunim me Programin e USAID-it për Fuqizimin e Sektorit të Drejtësisë në Kosovë - JSSP, ka realizuar trajnimin për gjyqtarët e Gjykatës Themelore në Ferizaj me temë “Etika Gjyqësore”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me zbatimin e Kodit të Etikës Gjyqësore të Kosovës, në mënyrë që këta të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë korrekte dhe të drejtë.

Në trajnim u potencua se nga gjyqtarët kërkohet të veprojnë me integritet në jetën e tyre private si edhe në jetën profesionale. Me tej u potencua se dukja e sjelljes së pahijshme gjyqësore ndikon në besueshmërinë e publikut, po aq sa edhe vëzhgimi i parregullsive gjyqësore në realitet. Në trajnim u veçua mendimi se komunikimet ex-parte midis një pale dhe gjyqtarit, edhe nëse nuk kanë të bëjnë fare me një lëndë, mund të krijojnë perceptimin në mendjen e publikut se ekziston korrupsioni në sistemin gjyqësor.

Pas një shtjellimi të gjithanshëm u veçua qëndrimi se përfshirja në mediat sociale si facebook, instagram, twitter, nuk është e ndaluar në mënyrë specifike, por një gjyqtar duhet të

shqyrtojë me kujdes ndikimin që një postim ose veprim tjetër në media sociale mund të ketë në reputacionin e tij gjyqësor dhe reputacionin e gjithë gjyqësorit.

Pas një debati u potencua se marrja e një dhurate, madje edhe e një vlere nominale e dhënë gjatë periudhës së festave, është e ndaluar në mënyrë specifike nga Kodi i Etikës Gjyqësore të Kosovës. Kodi i etikës përmban kërkesat që një gjyqtar nuk guxon të pranojë dhurata, pavarësisht nga vlera e tyre dhe ndalon pjesëtarët e stafit të gjykatës që të marrin dhurata. Gjithashtu në trajnim u ofruan zgjidhje praktike të bazuara në Kodin e Etikës të cilat do të lehtësojnë punën e gjyqtarëve dhe avancojnë njohuritë e tyre për kërkesat të konfidencialitetit për disa pjesë të caktuara të proceseve gjyqësore, dhe kufizimet në komunikimet gjyqësore me media për lëndët aktualisht në shqyrtim.

Në këtë trajnim u përdorën dhe u shtruan skenarë të rasteve që përfshijnë disa çështje praktike etike që gjyqtarët mund t'i hasin në punën e tyre të përditshme.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e Gjykatës Themelore të Ferizajt dhe gjyqtarët në degët e saj.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar

Aktivite e realizuara në muajin prill në trajnimin fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar

Akademia e Drejtësisë, gjatë muajit prill në kuadër të trajnimit fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar, ka vazhduar me realizimin e aktiviteteve të planifikuara sipas programit trajnues.

Në kuadër të trajnimit teorik, janë zhvilluar aktivitetet si në vijim: nën-moduli “Procedura Përmbare” është realizuar përmes dy (2) sesioneve trajnuese, nën-moduli “Procedura Kontestimore – pjesa e dytë” katër (4) sesione trajnuese, nën moduli “Marrja dhe administrimi i provave në procedurën civile ” tri (3) sesione trajnuese, nën moduli “E drejta familjare” tri (3) sesione trajnuese, si dhe nën moduli “E drejta trashëgimore” dy (2) sesione trajnuese.

Në kuadër të nën moduli Procedura Kontestimore – pjesa e dytë janë elaboruar këto tema: sigurimi i kërkesëpadisë, ndërprerja dhe pushimi i procedurës kontestimore, mosrespektimi i gjykatës, shpenzimet e procedurës kontestimore. Nga nën modulit Procedura Përmbare janë shtjelluar: përmbaremi në sendet e luajtshme dhe të paluajtshme, mjetet juridike në procedurën përmbaremi si dhe kthimi i punëtorit në punë.

Gjatë kësaj periudhe në kuadër të nën modulit e drejta familjare janë trajtuar: gjinia dhe llojet e saj, të drejtat dhe detyrat e bashkëshortëve, zgjidhja e martesës, procedura e shkurorëzimit, detyrimi për ushqim dhe e drejta prindërore, kundërshtimi dhe vërtetimi i amësisë apo i atësisë, birësimi, dhe marrëdhëniet pasurore në mes bashkëshortëve. Po ashtu në pjesën e

trajnimin teorik në këtë periudhë është realizuar edhe nën moduli e drejta trashëgimore ku fokusi ka qëndruar tek trashëgimia në bazë të ligjit, pjesa e domosdoshme dhe trashëgimtarët e domosdoshëm dhe transaksionet ndërmjet të gjallëve, trashëgimia në bazë të testamentit, padenjësia dhe përjashtimi i trashëgimtarëve të domosdoshëm, procedura për shqyrtimin e trashëgimisë, hapja e trashëgimisë, si dhe ndarja e trashëgimisë. Gjatë kësaj periudhe në kuadër të kompetencës profesionale gjyqtarët e sapo emëruar kanë pasur mundësi të shtjellojnë dhe zgjerojnë njohuritë lidhur me dëshmitarët dhe ekspertët në rastin e marrjes së provës, të kuptojnë zotësinë e personave të cilët duhet të dëshmojnë me qëllim të vërtetimit të fakteve relevante në një çështje kontestuese, si dhe rolin e procedimit të ekspertëve nga fushat përkatëse.

Ndërsa komponenta e trajnimit praktikë, për këtë periudhë është realizuar përmes vijimit të praktikës nga ana e gjyqtarëve të sapoemëruar në gjykata përkatëse, konform orarit të përcaktuar me program. Gjyqtarët e sapo emëruar gjatë muajit prill po ashtu kanë realizuar trajnimin në Shërbimin Sprovues të Kosovës dhe Agjencinë Kosovare të Privatizimit të cilët kanë pasur mundësi të diskutojnë për rolin, strukturën dhe problemet e shfaqura në praktikë.

Trajnimin fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar janë duke e ndjekur 54 gjyqtarë të sapo emëruar ku pesë prej tyre janë nga komuniteti serb.

Aktivitet e realizuar në kuadër të trajnimit fillestar për prokurorët e sapo emëruar

Gjatë muajit prill 2018, në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar për prokurorët e sapo emëruar, janë zhvilluar aktivitete trajnuese të cilat kanë përfshirë trajnimin teorik dhe atë praktikë.

Në kuadër të trajnimit teorik, janë zhvilluar aktivitetet si në vijim: nën-moduli “Kodi penal - pjesa e përgjithshme” është realizuar përmes katër (4) sesioneve trajnuese në këtë periudhë, nën-moduli “Kodi Penal – pjesa e veçantë” katër (4) sesione trajnuese, nën moduli “Konventa Evropiane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut” tri (3) sesione trajnimi, dhe nën moduli “Fillimi i hetimit formal dhe procedura penale” tri (3) sesione trajnimi.

Në kuadër të nën modulit Kodi Penal – pjesa e përgjithshme dhe e veçantë janë elaboruar këto tema: përgjegjësia penale, fazat e kryerjes së veprës penale, funksioni dhe sistemi i sanksioneve penale, karakteristikat kryesore të ekzekutimit të sanksioneve penale, veprat penale nga kapitulli XXVII, XXVII, XXVII, dhe XXIX. Ndërsa fokusi i nën modulit - Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka qëndruar tek: Këshilli i Evropës, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkatësisht neni 2, neni 4 i Protokollit 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe në kuadër të kompetencës profesionale, prokurorët e sapo emëruar kanë pasur mundësi të shtjellojnë dhe zgjerojnë njohuritë mbi procedurën paraprake-parashtrimi i kallëzimit penal, fillimi dhe kohëzgjatja e hetimeve si dhe pezullimi dhe pushimi i hetimeve.

Ndërsa komponenta e trajnimit praktikë, për këtë periudhë është realizuar përmes vijimit të praktikës nga ana e prokurorëve të sapoemëruar në prokuroritë përkatëse, konform orarit të përcaktuar me program. Prokurorët e sapo emëruar gjatë muajit prill po ashtu kanë realizuar trajnimin në Doganë e Kosovës të cilët kanë pasur mundësi të diskutojnë për rolin, strukturën dhe problemet e shfaqura në praktikë.

Trajnimin fillestar për prokurorët e sapo emëruar janë duke e ndjekur 22 prokuror të shtetit të sapo emëruar.



Trajnimi në Shërbimin Sprovues të Kosovës

Më datën 18 prill 2018, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar, ka realizuar trajnimin praktik me Shërbimin Sprovues të Kosovës. Qëllimi i këtij trajnimi ishte që gjyqtarët e sapo emëruar të njoftohen me rolin, funksionin dhe përgjegjësitë e Shërbimit Sprovues të Kosovës.



Në kuadër të këtij trajnimi praktik u prezantua një historik i shkurtër i themelimit, organizimit,

dhe funksionimit të saj. Njëkohësisht u trajtua veprimtaria e Shërbimit Sprovues, organizimi, zbatimi dhe mbikëqyrja e ekzekutimit të dënimeve alternative, ri-integrimi i personave të dënuar, mbikëqyrja dhe ndihma ndaj kryerësve të veprave penale të varur nga droga, ose alkooli të cilët i nënshtrohen trajtimit të detyrueshëm rehabilitues, si dhe ndihma ndaj personave të dënuar të liruar me kusht.

Po ashtu fokusi i trajnimit u përqendrua tek ngritja e vetëdijes shoqërore dhe bashkëpunimi me të gjitha organet e pushtetit shtetëror për humanizmin e ekzekutimit të dënimeve alternative, zvogëlimin e shkallës së recidivizmit dhe rritjen e përgjithshme të sigurisë për shoqërinë tonë”.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët e sapo emëruar, gjenerata e VI-të e PTF-së.



Trajnimi në Doganën e Kosovës

Më datë 25 prill 2018, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar për prokurorët e sapo emëruar, ka realizuar trajnimin praktik në Doganën e Kosovës.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte që prokurorët e sapo emëruar të njoftohen me rolin, funksionimin, përgjegjësitë, punën dhe aktivitetet që kryen Dogana e Kosovës.

Në kuadër të këtij trajnimi u shtjelluan çështjet që lidhen drejtpërdrejt me luftimin e

aktiviteteve ilegale, luftimi i krimit kufitar, luftimi i trafikimit të drogës, si dhe parandalimi kontrabandimit të armëve nukleare dhe substancave eksplozive

Gjithashtu në trajnim u potencua si bëhet mbledhja e taksave doganore, tatimit mbi vlerën e shtuar, akcizën për buxhetin e konsoliduar të Kosovës, kontrollimi i importit dhe eksportit, mbroja e ekonomisë dhe mbroja e markave tregtare.

Trajnimi u realizua përmes shpjegimeve teorike dhe diskutimeve interaktive, me ç ‘rast prokurorët e sapo emëruar patën rastin të shtrojnë pyetje të ndryshme për çështjet që ishin në fokus të trajnimit.

Përfitues të këtij trajnimi ishin prokurorët e sapoemëruar të gjeneratës së VII të PTF-së.



Aktivitetet për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive

Sistemi gjyqësor i Republikës së Kosovës – struktura dhe kompetencat

Më 11 prill 2018, Akademia e Drejtësisë, me mbështetje të GIZ-it, në kuadër të PTV-së realizoi trajnimin me temë “Sistemi gjyqësor i Republikës së Kosovës – struktura dhe kompetencat”.

Ky trajnim kishte për qëllim të avancoj njohuritë e stafit administrativ të gjykatave për kompetencat, strukturën organizative, mandatin dhe kornizën ligjore të sistemit gjyqësor në Republikën e Kosovës dhe kompetencat e sistemit gjyqësor. Në kuadër të këtij trajnimi u shtjelluan edhe zhvillimet aktuale rreth punës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK-së), aktet normative kryesore, dhe politikat e ndryshme për administrimin e sistemit dhe vendimet më të rëndësishme të tij.

Në trajnim u potencua se me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për KGJK-në, si dhe të Ligjit për Gjykatat, u

vunë themelet e një strukture të re organizative të gjyqësorit, si dhe u vendosën premiset mbi të cilat ndërtohet një gjyqësor i pavarur i cili administrohet nga vetë profesionistët e gjyqësorit.

Po ashtu fokusi u përqendrua në zbërthimin e kompetencave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës që janë paraparë me Kushtetutë dhe Ligjin për KGJK-në, në bazë të të cilave Këshilli ka rolin kryesor për sigurimin e pavarësisë dhe paañsisë së sistemit gjyqësor.

Tematikë me rëndësi ishte edhe emërimi i gjyqtarëve dhe kushtet që duhet të plotësojnë ata për emërim.

Përfitues të këtij trajnimi ishin stafi administrativ i gjykatave nga të gjitha nivelet dhe stafi i KGJK-së.



Sistemi prokurorial – struktura dhe kompetencat

Më 18 prill 2018, Akademia e Drejtësisë, me mbështetje të GIZ-it, realizoi trajnimin me temë “Sistemi prokurorial – struktura dhe kompetencat”.

Ky trajnim kishte për qëllim të avancoj njohuritë e stafit administrativ të prokurorive për kompetencat, strukturën organizative, mandatin dhe kornizën ligjore të sistemit prokurorial në Republikën e Kosovës.

Në fokus të trajnimit ishte korniza ligjore e sistemit gjyqësor-prokurorial, e kompetencave të Këshillit Prokurorial të Kosovës të parapara me Kushtetutë dhe Ligjin për KPK-në, si dhe organizimi i sistemit prokurorial.

Në kuadër këtij trajnimi u trajtuan edhe zhvillimet aktuale rreth punës së Këshillit Prokurorial të Kosovës, vendimet më të rëndësishme të tij, aktet normative kryesore dhe politikat e ndryshme për administrimin e sistemit. Gjithashtu u diskutuan edhe sfidat që paraqiten gjatë ushtrimit të mandatit të KPK-së, dhe Prokurorit të Shtetit.

Tematikë me rëndësi ishte edhe emërimi i prokurorëve dhe kushtet që duhet të plotësojnë për të ushtruar mandatin e prokurorit të shtetit.

Përfitues të këtij trajnimi ishin stafi administrativ i prokurorive nga të gjitha nivelet dhe stafi i SKPK-së.



Aktivitetet tjera

Programi i trajnimit për prokurorët - gjenerata e gjashtë e PTF, në Akademinë e Drejtësisë së Turqisë

Në kuadër të bashkëpunimit disa vjeçar të Akademisë së Drejtësisë së Kosovës me Akademinë e Drejtësisë së Turqisë dhe me



mbështetje nga Agjencia Turke për Zhvillim Ndërkombëtar (TIKA), me datë 2-6 prill 2018, u realizua programi i trajnimit “Krimi i Organizuar dhe Terrorizmi” në Akademinë e Drejtësisë të Turqisë, për gjeneratën e gjashtë të prokurorëve që sapo kanë përfunduar trajnimin fillestar në Akademinë e Drejtësisë së Kosovës.

Delegacioni i Kosovës i udhëhequr nga Drejtori Ekzekutiv i Akademisë z. Valon Kurtaj dhe në përbërje prej stafit të Akademisë, Drejtorit të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial dhe zyrtarëve tjerë nga KPK, si dhe prokurorëve, përveç trajnimit kishin rastin të vizitonin institucionet gjyqësore të Turqisë, të cilat kishin për qëllim shkëmbimin e përvojave në aspekte të ndryshme duke përfshirë edhe temën që aktualisht është shqetësim global – Krimi i Organizuar dhe Terrorizmi.

Delegacioni filloi me pritje dhe trajnime të cilat u mbajtën në Akademinë e Drejtësisë së Turqisë, në të cilat u pasqyrua struktura organizative, njësitë dhe objektet, kapaciteti i resurseve njerëzore dhe financiare, trajnimi fillestar në Turqi, mënyra dhe kërkesat për tu zgjedhur në profesion dhe të ngjashme.

Ditëve në vijim u vazhdua me trajnime nga fusha e luftimit të terrorizmit, gjithmonë duke tërhequr paralele dhe bërë krahasime mes sistemeve të së drejtës në fushën penale, me të cilat rregullohet e gjithë procedura për luftimin e kësaj dukurie.



Gjatë këtij programi, vizita zyrtare u realizuan në Prokurorinë e Përgjithshme, ku u pritën nga Kryeprokurori z. Mehmet Akarça, në Ministrinë e Drejtësisë së Turqisë të pritur nga nënsekretari i Ministrisë të Drejtësisë – z. Musa Heybet, dhe në Gjykatën e Kasacionit ku Sekretari i përgjithshëm z. Yusuf Ziaedin i prezantoi delegacionit të dhëna për sistemin e gjykatave në Turqi.



Vizitë studimore e delegacionit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve të certifikuar në nenin 10 të KEDNJ-së

Nga data 16-19 prill 2018, në Strasburg të Francës, me mbështetjen e projektit “Përforcimi i Ekspertizës Gjyqësore mbi Lirinë e Shprehjes dhe medias në Evropën Juglindore – JUFREX” është realizuar një vizitë studimore për gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët, trajnues të licencuar nga ky projekt, për nenin 10 të KEDNJ.

Qëllimi i vizitës ishte ngritja e njohurive të pjesëmarrësve në fushën e lirisë së shprehjes dhe të mediave në Evropën Juglindore.

Dita e parë e vizitës ju dedikua institucioneve që operojnë brenda Këshillit të Evropës lidhur me të drejtën e lirisë së shprehjes. Në trajnim u pasqyruan rezultatet e fundit të paraqitura nga Komisioni Mbikëqyrës për Media dhe Informim të Shoqërisë, duke vazhduar me një prezantim nga Këshilltari i Komisionarit për të Drejtat e Njeriut, që ka përfshirë analizën e rolit të institucionit dhe një fokus lidhur me vizitat e fundit të realizuara nga komisionari në Ballkan, gjatë të cilës një relevancë e madhe i është dhënë temës së lirisë së mediave. Çështjet tjera të trajtuara gjatë trajnimit u përqendruan në rolin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në caktimin e standardeve për lirinë e të drejtave të njeriut dhe mediave, dhe praktika e saj gjyqësore lidhur me nenin 10, sidomos sa i përket balancimit të saj me mbrojtjen e nenit 8 dhe rolit të gjyqtarit vendor brenda procedurave

të gjykatës.

Gjatë ditës së dytë pjesëmarrësit patën mundësinë e pjesëmarrjes në një seancë gjyqësore në lidhje me rastin Ilias dhe Ahmed kundër Hungarisë në Dhomën e Madhe të GJEDNJ, e cila edhe pse ishte e lidhur drejtpërdrejt me një shkëlqje të nenit 10 të KEDNJ, pjesëmarrësve u dha mundësinë për të parë punën e Gjykatës përmes rastit, dhe për të dhënë mendimin në lidhje me rastin në fjalë.

Kjo vizitë ka përmbyllë vitin e dytë të projektit, program i përbashkët i financuar nga Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian, i cili synon të arrijë nevojat specifike në fushën e lirisë së shprehjes dhe të mediave në Evropën Juglindore.

Përfituesë të vizitës ishin gjyqtarë, prokurorë dhe avokatë nga Kosova, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Serbia, si dhe përfaqësues nga institucionet e trajnimit gjyqësor nga rajoni.

Gjithashtu, përfaqësuesit e partnerëve kryesorë morën pjesë në Komitetin Drejtues të projektit JUFREX, ku u diskutuan rezultatet aktuale dhe aktivitetet e ardhshme të projektit.



Punëtori për diskutimin dhe hartimin e akteve normative, strategjike dhe kurrikulave trajnuese të Akademisë së Drejtësisë


Nga data 24-27 prill 2018, Akademia e Drejtësisë ka realizuar punëtorinë me temë: “Diskutimi dhe hartimi i akteve normative, strategjike dhe kurrikulave trajnuese të Akademisë së Drejtësisë”

Në fokus të kësaj punëtorie ishte vlerësimi i nevojave për hartimin e akteve normative të Akademisë së Drejtësisë, draft Planit Strategjik për periudhën 2019-2021 përfshirë edhe planin e veprimit dhe ndikimin financiar të zbatimit të tij, si dhe diskutimi i dokumenteve tjera strategjike kombëtare për nevojat e kurrikulës trajnuese të Akademisë së Drejtësisë.

Pas analizimit dhe diskutimeve të shumta, grupi punues ka hartuar këto dokumente duke u bazuar në parimet dhe mandatin ligjor të

Akademisë së Drejtësisë. Me rastin e kësaj punëtorie u diskutuan edhe vlerësimi i ndikimit të strategjive shtetërore, ERA, PKZMSA, raporti i KE-së për Kosovën në programin e trajnimeve të Akademisë, Programi kornizë i trajnimit si dhe nevoja e përcaktimit të moduleve trajnuese të sistematizuara sipas fushave në trajnimet e vazhdueshme si dhe nevoja për strategji të trajnimeve të specializuara.

Pjesëmarrës ishin Drejtori i Akademisë dhe stafi nga Departamenti i Programit dhe Departamenti për Administratë dhe Financa.



<https://ad.rks-gov.net>

**Adresa “Lagjja e Spitalit”
Rr. Muharrem Fejza p.n
Prishtinë, Republika e Kosovës**

**Tel: + 381 38 200 18 660
Fax: + 381 38 512 095
E-mail: infoad@rks-gov.net**